



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

## **PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Pune**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksion i vepres se marrjes dhe linjes se dergimit te fshatit Postribe”**

**Numri i referencës së procedurës REF-13040-07-12-2024**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247130-0 punime ndertimi per ujesjelles**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 15.095.260 (Pesëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) leke pa TVSH,** me financim nga Buxheti i Shtetit, I ndare:

Per vitin 2024, fondi limit 7.547.630 (Shtatë milion e pesëqind e dyzet e kater mijë e gjashtëqind e tridhjetë) leke pa tvsh.

Per vitin 2025 fondi limit 7.547.630 (Shtatë milion e pesëqind e dyzet e kater mijë e gjashtëqind e tridhjetë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Shkoder sh.a, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **Argumentimi :**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP 162/2020 "Per prokurimin publik", dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

**Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021- 2022 - 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

### **Argumentimi :**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, ky kriter i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.2.2** Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2021- 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur n.q.s dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet..

**Argumentimi:** Ky kriter eshte gjykuar si i domosdoshem per te percaketuar ecurine financiare te operatoreve ekonomik, pasi tregon raportin ndermjet aktiveve dhe pasiveve dhe eshte ne perputhje me percaketimin e nenin 43/4 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 . ky kriter i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

---

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshmeofertuesi duhet të dorëzojë:

1- Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vleres limit te objektit qe prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

2- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vleres limit te objektit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme me entet publike, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

*Kontratën e Sipërmarrjes,*

*Situacion përfundimtar të objektit,*

*Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit,*

*Aktin e dorëzimit të objektit,*

*Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse*

*Faturen/at tatimore*

Per objektet e financuara me fonde private:

*Kontratën e Sipërmarrjes,*

*Situacion përfundimtar të objektit,*

*Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit,*

*Aktin e dorëzimit të objektit,  
Faturen/at tatimore*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar ose për disa kontrata të marra sebashku është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit që prokurohet. Ky kriter i shërben autoriteti kontraktor si deshmë për mundësinë e realizimit të kontratës me sukses.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të leshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit në fuqi, e vlefshme me kategorite:

NP-1, Klasifikimi “A”  
NP-7, -Klasifikim ‘A’  
NS-18, -Klasifikimi ‘A’

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2001 ku janë të disiplinuarat procedurat perkatese të licensimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndertimit .

Pikat e licensave janë përcaktuar në baze të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.

NP-1, Klasifikimi “A” “punime germimi në tokë”, në preventiv ka zera të germimeve

NP-7, -Klasifikim ‘A’ “Ujesjellesa, gajesjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe ujitje” në preventiv dhe i gjithë objekti është punime reabilitim ujesjellesi

NS-18, -Klasifikimi ‘A’ “punime topogjeodezike”, në preventiv specifikimet teknike janë një seri zerash dhe procese pune që kanë të bëjnë me punime topogjeodezike.

### 2.3.3 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certificate:

ISO 9001:2015 - Certificate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise;  
ISO 45001:2018 - (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)  
ISO 14001:2015 - Certificate "Sistemin e menaxhimit te mjedisit"

Certificate duhet te jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen.

Ne rast bashkimi operatoresh, keto certificate duhet ti kete secili operator ekonomik ne baze te perqindjes se punimeve qe merr perisiper ne akt-marreveshje.

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane percaktuar bazuar ne nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomik te deshmojne se disponojne certificate e mesiperme. Keto kriteret jane te lidhura ngushtesisht, ne menyre te drejtperdrejte dhe ne perpjestim me natyren dhe objektin e prokurimit dhe duhet te jene te leshuara nga autoritetet kompetente ne menyre qe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates.

ISO 9001:2015 - Certificate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise; eshte tregues i realizimit me cilesi te punimeve objekt kontrate.

ISO 45001:2018 - (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), eshte tregues qe operatori ekonomik ofertues gjate kryrjes se proceseve te punes te garantoje shendetin dhe sigurine ne pune.

ISO 14001:2015 - Certificate "Sistemin e menaxhimit te mjedisit", eshte tregues qe operatori ekonomik ofertues gjate kryrjes se proceseve te punes te garantoje mbrojtjen e mjedisit.

### 2.3.4 Ofertuesi duhet te kete nje punesim mesatar jo me pak se 30 (Tridhjetë) punonjes , per muajin Korrik 2024. Kjo do te vertetohet me:

-Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per periudhen perkatese;

-Liste pagesat e punonjesve per periudhen perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si me lart).

**Argumentimi.** Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar personel i nevojshem referuar zerave te preventivit te objektit per realizimin e kontrates ne

mbeshtetje te pikës 4 të Nenit 77 te Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje te Nenit 39 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, si dhe në analizen bazuar në preventiv është përcaktuar numeri i nevojshëm i personelit që duhet të ketë ofertuesi. Numri i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohe, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve, të pakten:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier mekanik 1 (nje)
- Inxhinier gjeodet 1 (nje)
- Inxhinier gjellog 1 (nje)

Për drejtuesit teknik si më lart, ofertuesi duhet të paraqesë kontratat e punës, diplomat dhe CV.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 te Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje te Nenit 39 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit

kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë **janë operativë** pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.6. OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Grup Certifikues), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin Koorik 2024, jo më pak se:

- a. Teknik ndërtimi      1 (nje)
- b. Hidraulik            1 (nje)
- c. Karpentjer           1 (nje)
- d. Saldator             1 (nje)

Për punonjësit e mësipër duhet të paraqiten kontratat cv, dokumenti certifikues (si psh. Diplome, certifikate)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm profesional referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një



standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **teknik te profesioneve sipas zerave te preventivit** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në kryerjen e procesve të punës.

2.3.7. OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar, jo më pak se:

a. Manovratore 3 (tre)

b. Shofer 3 (tre)

Për plotësimin e kësaj kushti të paraqiten kontratat e punës, cv dhe dokumenti certifikues për profesionin.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm profesional referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **manovrator dhe shofera** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në përdorimin e mjeteve me qëllim realizimin e punimeve sipas zerave të preventivit.

2.3.8 Dëshmi për pronësi ose me qira të mjeteve dhe pajisjeve teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja	Argumentimi
1	Kamion me veteshkarkim	2 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
2	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
3	Rul me vibrim	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
4	Eskavatore me goma 0.25 m3	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
5	Eskavator me zinxhire	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter

				eshte konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
6	Pajisje per largimin e ujerave nentokesore me system gjilperthithese(sistemi Well Point i pajisur me pompe thithese, age, kolektor dhe aksesesor bashkues) thithese+tuba	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter eshte konsideruar si i domosdoshme bazuar ne specifikimet teknike ne seksionin 3.punimet e dheut, pika 303.3, ku thuhet: se duhet te merren te gjitha masat dhe pajisjet e nevojshme per tharjen e ujit qe te mundesohet shtrirja e tubave dhe derdhja e themeleve..
7	Pajisje topografike-sistemi Lidar scan 3D	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter eshte konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
8	Fadrome	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter eshte konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
9	Betoniere kantjeri	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter eshte konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.

10	Kamjonçine	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
11	Çekiç hidraulik	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
12	Gjenerator prodhim rryme	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
13	Vibro tokmak	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
14	Vibrator siperfaqesor	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.

15	Matrapik	1 cope	Në pronësi ose me qera	Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Ky kriter është konsideruar si i domosdoshme bazuar ne zerat e prevetivit per kryrjen e procesve te punes.
----	----------	--------	------------------------	--

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, tahografi, Certificate/licence transporti per vehte ,si dhe kontraten përkatëse të qerases dhe licencen e transportit per te tretet (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirases e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë për mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, në përputhje me zërat e punimeve sipas preventivit, projektit dhe specifikimeve teknike.

**2.3.9** Ofertuesi duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga Administratori.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

**NJESIA E PROKURIMIT**